

Nuk ka afat të caktuar për aplikim; aplikimet do të pranohen në mënyrë të vazhdueshme.

Nëse ju nevojiten më shumë informata, na kontaktoni në: +383 45 18 07 71 dhe/apo në info@kosovogenu.com



Mbështetur nga **UNICEF** në Kosovë



PROGRAMI I PUNËS PRAKTIKE

*Eksploroni interesat tuaja dhe
risni aftësitë për punësim*



Është hapur cikli i ri i programit të punës praktike të Kosovo Generation Unlimited (**K-GenU**)!

K-GenU fuqizon dhe punon me të rinjtë duke i lidhur me mundësitë për përmirësimin e tranzicionit të tyre nga shkolla në punë. Programi ofron punë praktike për të rinjtë që duan të fitojnë përvojë pune në mjedise profesionale dhe të ndërtojnë aftësitë e tyre, ndërkohë që u ofrohen trajnime dhe mentorë për t'i mbështetur në rrugëtimin e tyre.

Përmes një partneriteti të zgjeruar dhe nën udhëheqjen e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, UNICEF-it dhe Rrjetit CSR Kosova, kjo iniciativë e suksesshme e zhvillimit të aftësive dhe punësimit do të ofrojë hapësirë dhe mundësi për deri në 10,000 të rinj, duke filluar nga SOT!



Nëse dëshironi:



Të ndërtoni CV-në tuaj



Të keni mundësinë që të lidheni me entitete të sektorit publik dhe privat



Të angazhoheni në punë praktike tre-mujore – me kompensim financiar, duke u bazuar në fushën tuaj të interesit



Të ju caktohen mentorë për ngritjen e kapaciteteve dhe mbështetjen përgjatë rrugëtimin tuaj



Të përfitoni nga mundësitë e trajnimit dhe qasje në qendën tonë të burimeve

Dhe nëse jeni:

16-24
vjeçar

atëherë programi i punës praktike **Kosovo Generation Unlimited** është programi i duhur për ju!

Si të bëheni pjesë e programit të punës praktike K-GenU:

Hapi 1



Regjistrohuni në platformën digjitale www.kosovogenu.com/register



Hapi 2



Krijoni profilin tuaj.

Hapi 3



Përcillni shpalljet e postuara nga kompanitë dhe organizatat në platformën digjitale apo aplikacionin mobil dhe shprehni interesimin tuaj duke aplikuar direkt aty.

Hapi 4



Pasi të aplikoni, mbi ecurinë dhe statusin e aplikimit do të njoftoheni përmes emailit apo njoftimeve në telefonin tuaj.